



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.511/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Ferit Osmani dhe Vllastimir Dimiq, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Afërdita Shpejti kryesuese e vendvotimit 2004A/03D në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Fryma e Re (FER).

ARSYETIMI

Më datën 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik FER në të cilën theksohet se me datën 12.12.2010 në shkollën fillore Motrat Qiriazi në Prizren ,vendvotimi 2004A/03D me kryesuese Afërdita Shpejta , me ç`rast në këtë klasë deri në orën 12:40 kanë votuar 172 persona dhe më pas janë verifikuar dy probleme:1) Baterit nuk funksionojn dhe 2)Vula nuk punon (është e kthyer mbrapsht).Më pas, sipas parashtruesit të ankesës në orën 12:40 është mbyll kjo qendër dhe e ka ndërprerë pinën deri në ora 13:05.Më pas,sipas parashtruesit të ankesës,kryesuesi i vendvotimit ka thënë se 172 votat për shkak të vulës nuk do të numërohen.Pastaj gjithnjë sipas parashtruesit të ankesë, janë munduar të kontaktojnë KKZ-ën në Prizren,e ata nuk kanë pasur informacionin e tillë dhe se kanë thënë se gjithçka është në rregull diku ka ora 16:00

Ne mbështetje te pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë prove materiale.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshtë:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

PZAP-i vlerëson se ankesa e FER-it paraqitur kundër kryesuesit të vendotimit është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe rregullimin e aparateve për identifikim si dhe vulave të tyre fakt ky që konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 511/2010 më datën 14.12.2010

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

